



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË

Numri i lëndës: 2023:165311

Datë: 31.07.2024

Numri i dokumentit: 06004409

**P.nr.231/23**

**GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË** –Departamenti i Përgjithshëm, gjyqtarja Marigona Lajqi, në çështjen penale kundër të pandehurit: I.M., për shkak të veprës penale: Vjedhja e shërbimeve nga neni 314 paragrafi 1 Kodit nr. 04/L-082 Penal të Republikës së Kosovës (*tutje si: KPRK*), sipas aktakuzës së Prokurorisë në Mitrovicë - Departamenti i Përgjithshëm PP.II.nr.1006/23 të datës 01.08.2023 duke vendosur lidhur me Marrëveshjen e Ndërmjetësimit ND.nr.1306/2024, të datës 29.07.2024, të lidhur në mes të pandehurit I.M. dhe palës së dëmtuar K....., përfaqësuar nga V.L., jashtë seancës, e në mbështetje të nenit 357 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës (*tutje si: KPP*) dhe nenit 2 paragrafi 2, nenit 8 dhe nenit 15 paragrafi 1 të Ligjit Nr. 06/L-009 për Ndërmjetësim (*tutje: Ligji për Ndërmjetësim*), me datë 31.07.2024 mori këtë:

**A K T V E N D I M**

1. APROVOHET Marrëveshja e Ndërmjetësimit ND.nr.1306/2024, e datës 29.07.2024 e lidhur në Gjykatën Themelore në Mitrovicë, në mes palëve: të pandehurit I.M. dhe palës së dëmtuar K....., përfaqësuar nga V.L.
2. HEDHET Aktakuza e Prokurorisë Themelore në Mitrovicë – Departamenti i Përgjithshëm PP.II.nr.1006/23 të datës 01.08.2023, dhe PUSHOHET procedura penale kundër të pandehurit: I.M., nga i ati H....., e ëma Xh....., e vajzërisë Sh....., i lindur me datë ..... në fshatin M....., ku edhe jeton, me numër personal ....., shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës për veprën penale: Vjedhja e shërbimeve nga neni 314 paragrafi 1 i KPRK-së.
3. Shpenzimet e procedurës penale mbulohen nga mjetet e gjykatës.

## **A r s y e t i m**

Prokuroria Themelore në Mitrovicë – Departamenti i Përgjithshëm, ka parashtruar aktakuzën PP.II.nr.1006/23 të datës 01.08.2023, kundër të pandehurit I.M., për shkak të veprës penale: Vjedhja e shërbimeve nga neni 314 par. 1 të KPRK-së.

Me datën 29.07.2024, në Gjykatën Themelore në Mitrovicë është arritur Marrëveshja e Ndërmjetësimit ND.Nr.1306/2024, në mes palëve në procedurë dhe atë të pandehurit I.M. dhe të dëmtuarës K.....

Andaj, Gjykata duke vepruar konform dispozitave të nenit 2 paragrafi 2 dhe nenit 15 paragrafi 1 të Ligjit për Ndërmjetësim, e aprovoi këtë marrëveshje pasi që të njëjtën e vlerësoi që është lidhur me vullnetin e palëve në procedurë dhe në pajtim me ligjin në fuqi.

Gjykata, pasi ka vërtetuar se në këtë çështje penale është arritur marrëveshje në procedurën e ndërmjetësimit, sipas Ligjit për Ndërmjetësim, dhe aprovimit të kësaj marrëveshje nga ana e Gjykatës duke u mbështetur në nenin 15 paragrafi 1 të Ligjit për Ndërmjetësim, Gjykata konstaton se kjo është një rrethanë e cila e pengon ndjekjen e mëtejme penale dhe mbi bazën e këtyre arsyeve e duke u bazuar në nenin 357 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 të KPP-së, vendosi që të hedhë aktakuzën dhe të pushoj procedurën penale ndaj të pandehurit.

Bazuar në nenin 15 paragrafi 1 të Ligjit për Ndërmjetësim, në datën e aprovimit të kësaj marrëveshje nga gjykata, përkatësisht nga data 31.07.2024 do ta ketë fuqinë e titullit ekzekutiv. Nga sa u tha më lartë dhe konform nenit 357 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 të KPP-së, e lidhur me nenin 2 dhe nenin 15 paragrafi 1 të Ligjit për Ndërmjetësim, u vendos si në dispozitiv të këtij Aktvendimi.

**GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË**  
**Departamenti i Përgjithshëm/ Divizioni Penal**

**P.nr.231/23, datë 31.07.2024**

Gjyqtarja

---

Marigona LAJQI

**KËSHILLA JURIDIKE;** Kundër këtij Aktvendimi është e lejuar ankesa e personave të autorizuar në afatin prej tri (3) ditësh nga pranimi i tij, përmes kësaj Gjykate, për Gjykatën e Apelit të Kosovës në Prishtinë.